# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-434946**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Hetimet ndaj Ballukut përplasin Erald Kaprin dhe Faik Bashën në “Shqipëria Live”/ Eksperti i sigurisë kundërshton deputetin: Në fund vendos gjykata |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/10/hetimet-ndaj-ballukut-perplasin-kaprin-dhe-bashen-ne-shqiperia-live-basha-kundershton-kaprin-ne-fund-vendos-gjykata321/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 12:33:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 10 shtator 2026, 12:03:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 10 shtator 2026, 12:02:00 UTC → 10 shtator 2026, 12:04:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c2281ed6f673984b4bbccf9598f2e9289aff0ae0a046588ca9d02de53b76150d` |
| TEKSTI | `188df7ae7cc1d056297c93a064f9c94ab47de8903e6ab8979478d6028efee6fd` |
| PAMJA | `76bdeef99d56eac248a6477f978eae1b81b5785c2b000ab28fef4d5236001b95` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fe0346f32d5f7a31ea6487d7eafe12e1d4f412cbcdc356d5e85599d5170e994d` |
| E MËPARSHMJA | `6994109302a426be5a6fd1c096ac0d42c89cb9d887713d5be6044aac7beddca3` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fe0346f32d5f7a31ea6487d7eafe12e1d4f412cbcdc356d5e85599d5170e994d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Hetimet ndaj Ballukut përplasin Erald Kaprin dhe Faik Bashën në "Shqipëria Live"/ Eksperti i sigurisë kundërshton deputetin: Në fund vendos gjykata

10/09/2026 14:03

Hetimet e SPAK ndaj ish zëvendëskryeminsitres Belinda Balluku dhe qëndrimi i mazhorancës për çështjen e saj kanë përplasur në studion e "Shqipëria Live" deputetin e Partisë Mundësia, Erald Kapri, me ekspertin e sigurisë Faik Basha.

Debati u përqendrua te hetimet e SPAK dhe te fakti nëse akuzat ndaj Ballukut mund të konsiderohen të mjaftueshme për të kërkuar përgjegjësi, apo nëse për këtë duhet pritur një vendim i gjykatës.

Kapri akuzoi mazhorancën se po mbron Ballukun dhe se po cënon parimin e barazisë para ligjit, ndërsa Basha theksoi se akuza nuk provon fajësinë dhe se është gjykata ajo që duhet të japë fjalën përfundimtare.

**Pjesë nga debati në studio:**

**Pjesë nga debati në studio:**

Pyetje: A jeni ju pro faktit që një person që ka akuza të arrestohet, apo të hetohet dhe nëse del fajtor të arrestohet?

Kapri: Këtë e vendos prokuroria dhe gjykata. Po bëhet viti që kur ka nisur çështja Balluku dhe sot kemi të bëjmë me një triumf të SPAK. Hetimi i SPAK zbuloi se kemi të bëjmë me korrupsion dhe pastrim parash. Ka një luftë mes pushteteve në Shqipëri, të Ramës dhe drejtësisë. Kjo përbën ngërçin që kemi. Beteja me drejtësinë, sado të zgjatet, do të jetë e humbur.

**Faik Basha**: Jeni duke folur për A-në e gjësë. Prokuroria është organi i akuzës, që s'do të thotë se kemi të bëjmë detyrimisht me një fakt konkret. Është duke u hetuar. Realisht jemi tek A-ja e gjësë. Ajo që SPAK ka komunikuar dje është në vijimësi të hetimeve, që nuk mund të themi që kemi prova të vlerësuara nga gjykata për të pasur një fajësi. Deri tani nuk kemi fakte, vetëm organin e akuzës që po bën hetimet.

**Kapri:** Unë të kundërshtoj, është shprehur dhe gjykata.

**Faik Basha**: Fakti i rëndësishëm është vendimi përfundimtar.

**Kapri:** Apo trajtohet e barabartë para ligjit Balluku?

**Faik Basha**: Po trajtohet.

**Kapri:** Zero.

**Faik Basha**: Kemi një SPAK që po kryen detyrën në mënyrë të përkryer. Pjesën më të madhe të pushtetit zonja e ka dorëzuar. Edhe çështja e imunitetit e di pse ka lindur? Sepse je target i krahut të kundërt politik. Zoti Kapri është deputet dhe ka të drejtën të mbajë anën politike.

**Kapri:** Shehaj është përjashtuar nga Parlamenti sepse ka kërkuar dosjen Balluku. Çfarë shteti është ky? Ka rënë shteti me zonjën Balluku, nuk ka më ndarje pushtetesh apo barazi para ligjit.

**Faik Basha**: Në fund gjykata do të vendosë. Ne kemi një qeveri që ka dhënë kontributin kryesor të sistemit gjyqësor. Kemi sot zyrtarë të lartë që hetohen, arrestohen pa dalë në vendime.

**Kapri:** Te rasti i Ballukut, nuk është rasti te zonja Balluku. Në momentin që zonjës i erdhi akuza nga SPAK, ndryshoi qëndrimi i Ramës. Zonja u mbrojt, nuk iu hoq imuniteti

**Faik Basha**: Akuza nuk provon fajësi.

**Kapri:** Ne duhet të jemi të barabartë para ligjit.

**Faik Basha**: Prokuroria po heton çdo ditë, nuk i ka mjaftuar koha dhe ka marrë dhe 3 muaj.

**Kapri:** Parlamenti është bërë si gjykatë, pushteti legjislativ ka ndërhyrë.

**Faik Basha**: Nuk mendoj se Parlamenti duhet të votojë çdo gjë.

**Kapri:** Parlamenti nuk duhet të mbrojë.

**Top Channel**


Kryesore »
Situata me zjarret në vend, 10 vatra aktive, qindra forca dhe mjete në terren
10/09 14:52
Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinës, merr kthesë krimi makabër, familja në agoni pas detajeve të reja
10/09 14:44
"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social
10/09 14:25
Ngërçi me pagat e magjistratëve/ Kallëzimi në SPAK përfshin 16 degë të Thesarit, kërkohet zbardhja e gjithë zinxhirit të vendimmarrjes
10/09 14:23
SPAK zbërthehen skemën e mashtrimit kompjuterik/ Burg për shqiptarët, si i fusnin në kurth qytetarët në disa shtete dhe u merrnin paratë
10/09 14:12
"Shtëpi për 4 mijë çifte të reja", Rama prezanton programin e ri për strehimin social: Do përdoren objektet e konfiskuara, si do të bëhet ndarja për 6 kategoritë
10/09 14:11
Politikë »
Vrau shqiptarin dhe e dogji brenda makinës, merr kthesë krimi makabër, familja në agoni pas detajeve të reja
10/09 14:44
"S'do bëjnë më tendera siç kanë bërë"/ Taksat për kullat në qytete, Rama: Të ardhurat do shkojnë te Fondi i Strehimit, Enti i Banesave do kthehet në kompani publike
10/09 14:22
Pagat e gjyqtarëve, ministri Gogu: Zgjidhja vjen nga Kuvendi, kujdes shëndetin e buxhetit të shtetit
10/09 13:30
Veliaj drejt Gjykatës së Strasburgut, SPAK nuk pranon takimin e 10 shtatorit me avokatët britanikë për firmosjen e aplikimit
10/09 13:21
Kallëzimi i gjyqtarëve ndaj Ministrit të Financave, reagon Rama: Mungon emri im dhe i Ministrit të Drejtësisë, pagat rriten me vendim të Kuvendit
10/09 12:47
"Plaka ime nuk di të përdori pultin, jo më e-Albania"/ Korreshi përplaset me Manjën te 'Ligjet', socialisti: Do t'i rregullojmë, ke pyetje të tjera?
10/09 12:45
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top News – 'T'i vëmë fre Inteligjencës Artificiale.' Diskutimet te Ligjet për Konventën Europiane
Top Channel/ Taksat për kullat, Rama: Të ardhurat do shkojnë te Fondi i Strehimit, jo tendera për…
Top Channel/ Skandal me "call-centerat" në Ukrainë, DW: Të përfshirë zyrtarë të Prokurorisë!
Top News – 'SPAK të hetojë Tigrat e energjisë'. PD: ERE nuk i licencon, KESH u jep 20 mln euro
Top Channel/ "2 mijë kredi me interes 0, do i mbulojë Qeveria", Rama: 2 mijë të tjera me interes 3%
Top Channel/ Shqipëria në pushtetin e flakëve, Rama: Djallëzi njerëzore dhe fatkeqësi natyrore
Kryesore
"Shumë shpejt do i japim fund historisë së pajustifikueshme të rindërtimit", Rama me tone të ashpra për Veliajn: Prerja e kokës së kryeqytetit, eksperimenti më i rëndë social
14:25
Protesta në fushën naftëmbajtëse Patos-Marinëz nis me tensione, banorët hyjnë në ambientet e Bankers Petroleum
08:56
Kontrolle në Lezhë, bllokohet 'bisha' "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin
11:35
"Ngushticës së Hormuzit do t'i vë emrin tim"/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit
07:37

Transferimi më i shtrenjtë në historinë e Real Madridit, por Diomande ende nuk ka debutuar si titullar
09:44
Më të lexuarat
Panik tek ukrainasit/ Aeroplani i Zelenskyt i shpëton sulmit me dron në Moldavi, ishte nisur drejt funeralit të mbretit norvegjez Harald V
“Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit”/ Vance: Tarifat nuk mjaftojnë për premtimin e Presidentit
Sot gjyqi në Hagë, Prokuroria: Thaçi tentoi ta pengonte procesin gjyqësor duke ndikuar te dëshmitarët
Bllokimi i rrugëve nga protestuesit, Rama replikon sërish me “Demokratët Europianë”: A do kishit mirësinë ta dënonit dhe këtë akt?
Kontrolle në Lezhë, bllokohet ‘bisha’ “Rolls-Royce”, nis hetimi pasuror për pronarin
“Ngushticës së Hormuzit do t’i vë emrin tim”/ Premtimi i ri i Trumpit: Pesë mijë dollarë për çdo amerikan të rritur nëse fitojmë zgjedhjet e mesmandatit
Shqipëria e para në rajon për shkencë dhe matematikë, ana tjetër e rezultateve të PISA-s: Gjysma e 15-vjeçarëve nuk arrijnë nivelin bazë
Nisin hetimet për mjeken pas vdekjes së ikonës së muzikës greke, Mazonakis u përkeqësua në klinikën private, zbulohet trajtimi që po bënte
“Gjetja” e shqiptarëve për fshehjen e drogës te lulet, shikoni si janë “transformuar” trëndafilat që bënin transportin nga Kolumbia në Greqi
Projektligji i ri në Kuvend/ Subjektet me ndërtime pa leje 6 muaj kohë për vetëdeklarim. Shteti merr përsipër pallatet e lëna përgjysmë



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së këtij faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.